



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 1857 Prot

Shkodër, më 30. 01. 2024



**SHOQATA PROJEKTI SHPRESA**

Nr. 17 Prot

Shkodër, më 30. 01. 2024

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, ndërmjet palëve si më poshtë:

**Bashkia Shkodër**, me Kryetar të Bashkisë Shkodër **Z. Benet Beci**, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nga Zv/Kryetari Z. Onid Bejleri, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, adresë: Rruga 13 Dhjetori, Nr.1- Shkoder, këtë e tutje e cilësuar si Bashkia.

*dhe*

**Shoqata "Projekti Shpresa"**, me adresë: Rruga Arra e madhe, Nr. 108, përfaqësuar nga **Z. Luigj Mila**, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta/kartë identiteti me nr. G60523114D si dhe me nr NIPT-i **K47121001G** themeluar në vitin 1995 sipas vendimit të gjykatës nr. 8/1, dt 20/07/2006.

#### **Baza ligjore**

- Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar;
- Ligji nr. 84, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar, aneksi 4
- Ligji nr. 97/2023, datë 07.12.2023 "Për buxhetin e vitit 2024", aneksi 4
- Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- VKM nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, (lidhja II, klasa VII për Kujdestarët Social)

- VKM nr 325 ,datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar **Lidhja I, klasa III-3 për Titullarin.**
- VKM nr.822 date 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”
- VKM nr. 518, datë 04.9.2018,“Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.
- Udhëzim nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore“i ndryshuar.
- Udhëzimit nr. 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar.
- VKB Nr. 71, Datë 27.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.
- VKB Nr.55, Datë 29.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër".
- Kërkesë nga Shoqata Projekti “Shpresa” nr 1002, datë 17.01.2023 “ Kërkesë për ndryshim shpërndarje fondi në zërat e marrëveshjes së vitit 2023”
- Kërkesa nga Shoqata Projekti Shpresa nr.1546 prot, datë 25.01.2024 “Për Shpërndarje buxheti për vitin 2024.

## NENI I

### Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është ofrimi i shërbimeve cilësore për personat me aftësi të kufizuar sipas standarteve të miratuara pranë qendrave të projektit “Shpresa” Planifikimi i fondit dhe përgatitja e procedurave për lëvrimin e financimeve për pagat dhe siguracionet e personelit, të kuotës ushqimore për përfituesit që përfitojnë shërbime pranë organizatës “Shpresa” si dhe shpenzime operative.

## NENI II

### Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë së Shkodrës dhe Projektit “Shpresa” në zbatimin e programit të

bashkëpunimit me qëllim ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar sipas standarteve të përcaktuara me ligj.

Projekti Shpresa, ofron shërbime të tipit shtëpi – familje, në territorin e Bashkisë së Shkodrës për personat me aftësi të kufizuar. Aktualisht projekti Shpresa përbëhet nga 7 shtëpi familje ku marrin shërbim 63 përfitues, të deinstitutionalizuar nga qendrat psikiatrike shtetërore, qendrat e zhvillimit, etj. dhe marrin shërbime sipas nevojave me synim integrimin e tyre në shoqëri. Përfituesit janë ndarë në shtëpi-familje sipas shkallës së paaftësisë (sipas vlerësimit të komisionit mjeko-ligjor që paraqesin dhe sipas aftësisë vet-vepruese që ata kanë).

### **NENI III**

#### **Afati i marrëveshjes së bashkëpunimit**

Efektet financiare të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të jenë deri më 31/12/2024.

### **NENI IV**

#### **Rolet dhe përgjegjësitë e projektit “Shpresa”**

- Projekti “Shpresa” ofron shërbim të përkujdesit rezidencial dhe ditor për fëmijë dhe të rinj, jetimë biologjik apo socialë, me aftësi të kufizuar, dhe/ose të dalë nga institucionet publike të përkujdesit rezidencial, shtëpi fëmije apo Qendër Zhvillimi.
- Projekti “Shpresa” administron shtëpi familjet dhe ofron shërbim për përfituesit e shërbimeve në përputhje me standartet sipas VKM nr. 822, datë 06.12.2006, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”.
- Projekti Shpresa duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë së Shkodrës çdo muaj një raport narrativ mbi ecurinë e shërbimit të ofruar për përfituesit (të dhëna mbi numrin e përfituesve, shërbimet e ofruara, problematika të veçanta për periudhën e raportimit, aktivitetet e zhvilluara gjatë muajit, aspekte të veçanta, etj.)
- Projekti “Shpresa” merr përsipër të mbulojë kuotën ushqimore për vitin 2024 për përfituesit dhe faturat e ujësjellësit.
- Projekti “Shpresa” bashkëpunon me Bashkinë Shkodër për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar, që janë banorë të Bashkisë Shkodër. Për çdo ndryshim që mund të ndodhë përsa i përket numrit të përfituesve (kthim në familje, transferime, vdekje, etj.) si edhe numrit të personelit shërbyes, Projekti “Shpresa” duhet të informojë në rrugë zyrtare Bashkinë Shkodër.
- Për lëvrimin e fondit të vënë në dispozicion në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, Projekti “Shpresa” çdo fillim muaji brënda datës 10 të çdo muaji duhet të paraqesë pranë Bashkisë së Shkodrës dokumentacionin si më poshtë:
  - Kërkesë për transferim fondi të detajuar;
  - Bordero të punonjësve në paga bruto dhe neto;

- Bordero të sigurimeve të gatshme për deklarimin e Sigurimeve Shoqërore dhe TAP në Degën e Tatimeve;
  - Relacionin narrativ mbi ofrimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të muajit paraardhës;
  - Në momentin e pagesës së muajit që vjen pas, duhet të paraqiten edhe urdhër xhirimet që vërtetojnë pagesat e bëra për muajin paraardhës;
  - Listë të përfituesve për muajin për të cilin do bëhet pagesa.
- Çdo fillim muaji paguhen pagat e muajit paraardhës.
  - Faturat e energjisë elektrike të çdo muaji, të shtëpi – familje të Projektit Shpresa, për 7 shtëpi familje dhe kamp veror në Velipojë .
  - Në rastet e blerjes së materialeve të ndryshme, kryerjes së shërbimeve, për likuidimin e tyre, projekti “Shpresa” duhet të sjellë dokumentacionin sipas procedurës ligjore të menaxhimit të fondeve publike.

## NENI V

### Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

Bashkia e Shkodres, ka miratuar fondin me VKB Nr.55, Datë 29.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", ka miratuar Programi 10430: Kujdesi social për familjen dhe fëmijët, P10430.Q4.O2.A2. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar, si një domosdoshmëri për mbështetje në ofrimin e shërbimeve alternative për personat me aftësi të kufizuar, pa asnjë perkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme dhe me qëllimin kryesor që këto shërbime të ofrohen sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike.

Fondi i parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi me Projektin “Shpresa” është **21,295,323** lekë ku **20,973,000** lekë nga buxheti i vitit 2024 dhe **322,323** lekë nga tepricat nga fondi i vitit 2023 që do të përdoren në vitin 2024 në vlerën **165,852.8** për pagesat e energjisë elektrike dhe likuidimi i faturave të energjisë dhe ujit për muajin dhjetor 2023 në vlerën **156,470.2** lekë.

Shumë kjo e ndarë si më poshtë:

- Paga për 26 kujdestarë – 18,952,224 lekë.
- Paga për administratorin, – 1,526,436 lekë.
- Energji Elektrike – 660,192.8 lekë.
- Energji Elektrike Dhjetor 2023 – 148,262.2 lekë
- Ujë Dhjetor 2023 – 8,208 lekë

\* Me anë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të likujdohen faturat e energjisë dhe ujësjellësit të muajit dhjetor 2023 në vlerën 148,262.2 për energjinë elektrike dhe 8,208 për faturat e ujësjellësit sipas kërkesës së dërguar për ndryshim shpërndarje fondi për marrëveshjen e vitit 2023 nr. 1002 Prot. 17.01.2024.

Pagat e punonjësve mbështetës të Shoqata “Projekti Shpresa” janë të llogaritura sipas Vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, **(lidhja II, klasa VII për Kujdestarët Social)**

Pagat për titullarin, janë të llogaritura sipas VKM –së nr 325 ,datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, i ndryshuar **Lidhja I, klasa III-3 për Titullarin.**

- Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik përgatit relacionin dhe shkresën përcjellëse për lëvrimin e fondit, për drejtorinë e financës, pasi projekti Shpresa sjell dokumentacionin e përcaktuar në nenin IV të kësaj marrëveshje,
- Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik monitoron ofrimin e shërbimeve të ofruara në projektin “Shpresa”.
- Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik bashkëpunon me projektin “Shpresa”, për sistemimin e personave me aftësi të kufizuar, që janë banorë të Bashkisë Shkodër.
- Bashkia Shkodër, çdo fillim muaji paguan pagat e muajit paraardhës.
- Efektet financiare për këtë marrëveshje bashkëpunimi do të jenë sipas kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje, përcaktuar në nenin nr. III të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

## NENI VI Mënyra e lëvrimit të fondit

Drejtorja e Financës pranë Bashkisë Shkodër, brenda datës 20 të çdo muaji do të bëjë transferimit e vlerës mujore në varësi kjo edhe në varësi të datës së kërkesës që Projekti “Shpresa” sjell pranë Bashkisë Shkodër, nga fondi i miratuar, në llogari të shoqatës Projekti “Shpresa” në numrin e llogarisë 30950321803, IBAN AL 1020851183000030950231803, në bankën Intesa Sanpaolo Bank.

**NENI VII**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

**NENI VIII**  
**Dispozita të fundit**

- Kjo Marrëveshje hartohet në katër kopje të barazvlefshme.
- Në rast të zvogëlimit të numrit të punonjësve, fondi do të zvogëlohet në raport me numrin e punonjësve.
- Çdo rregullim ose ndryshim në këtë marrëveshje bashkëpunimi bëhet vetëm në formë të shkruar dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.
- Palët e kësaj Marrëveshje bien dakort të zgjidhin me marrëveshje përmes bisedimeve çdo keqkuptim mes tyre.
- Palët pasi e lexuan marrëveshjen, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan atë.

**PËR**  
**BASHKINË SHKODËR**

**KRYETAR**

**Benet Beci**

**Me Vendim delegimi**

**Zv/Kryetar**

**Onid Bejleri**



**PËR**  
**Shoqatën Projekti SHPRESA**

**PRESIDENT**

**Luigj Mila**

